



Letër e hapur

Drejtuar: Z. Altin Dumani

Kreu i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Lënda: Rasti i gazetarit Elton Qyno

I nderuar zoti Dumani,

Ne, antarët e Rrjetit Safe Journalists dhe organizatat partnere të Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Medias (MFRR) si dhe Reporterët pa Kufinj po ju shkruajmë për të shprehur shqetësimet tona mbi veprimet e fundit të ndërmarra nga SPAK ndaj gazetarit Elton Qyno. Vendimi për të sekuestruar pajisjet e zotit Qyno dhe për t'i bërë presion për të zbuluar burimet e tij është një çështje e rëndësishme për ne si organizata të përkushtuara për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, lirisë së medias dhe integritetit gazetaresk. Veprimet e kryera ndaj z. Qyno, përfshirë kontrollin e banesës dhe zyrës së tij dhe sekuestrimin e pajisjeve personale dhe profesionale, përbëjnë një precedent shqetësues. Masa të tilla do të ndikojnë në të drejtat e gazetarëve dhe lirinë e medias në Shqipëri dhe më gjerë.

Ne e njohim domosdoshmërinë e pajtueshmërisë ligjore në proceset gjyqësore. Megjithatë, balancimi i kësaj me parimin e njohur ndërkombëtarisht të mbrojtjes së burimeve gazetareske është thelbësor. Ky parim nuk është vetëm kritik për të drejtat e gazetarëve, por është gjithashtu thelbësor për të drejtën e publikut për informim dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të një shoqërie demokratike.

Nisur nga këto konsiderata, i bëjmë thirrje SPAK-ut të rivlerësojë qasjen e tij në këtë rast. Kthimi i pajisjeve të sekuestruara zotit Qyno dhe ndërprerja e të gjitha përpjekjeve për të zbuluar burimet e tij do të tregonte mirëkuptim, respektim, dhe mbrojtje të lirisë së medias dhe të burimeve gazetareske në Shqipëri. Kjo qasje do të përputhej me standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe entitete të tjera ndërkombëtare të dedikuara për lirinë e medias.

I bëjmë thirrje zyrës suaj që t'i japë përparësi mbrojtjes së burimeve gazetareske, e cila është themelore për ruajtjen e lirisë së shtypit dhe parimeve demokratike. Marrëdhënia e besimit midis gazetarëve, burimeve të tyre, publikut dhe zbatimit të ligjit varet shumë nga respektimi dhe ruajtja e këtyre vlerave.

Ne ju falënderojmë për vëmendjen tuaj ndaj kësaj çështjeje dhe presim me padurim një vendim që mbështet lirinë e medias dhe mbron burimet gazetareske në Shqipëri. Organizatat tona do të vazhdojnë të monitorojnë nga afër situatën dhe të raportojnë çdo zhvillim të mëtejshëm.

SafeJournalists Network

Association of Journalists of Kosovo

Association of Journalists of Macedonia

BH Journalists Association

Croatian Journalists' Association

Independent Journalists Association of Serbia

Trade Union of Media of Montenegro

European Center for Press and Media Freedom

European Federation of Journalists

Free Press Unlimited

International Press Institute

OBC Transeuropa

Reporters without Borders